



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR TË BASHKISË KAMËZ TË PROPOZUAR  
NGA KOALICIONI "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE" Z. RAKIP BAJRAM SULI  
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 15.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kamëz z. Rakip Bajram Suli të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore datës 30 Qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", neni 67, pika 2, neni 165, pika 3 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 07.05.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane". Sipas marrëveshjes së Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane",



**Nr. 357 i Vendimit**

**Data 15.05.2019**

**Ora 11:00 e Vendimit**

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kamëz të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", **z. Rakip Bajram Suli** për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

kryetari i Partisë Socialiste të Shqipërisë, Z. Edi Rama do të jetë personi i cili do të autorizojë personat përgjegjës për të firmosur në emër të koalicionit kërkesën për rregjistrimin e kandidatëve për Kryetar Bashkie.

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" ka depozituar në KQZ Kërkesën për rregjistrimin e z.Rakip Bajram Suli si kandidat për kryetar të bashkisë Kamëz.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të rregjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkisë Kamëz, pasi Bashkia Kamëz, administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë listuar:

1. Kërkesë për rregjistrimin e z. Rakip Bajram Suli si kandidat për kryetar të bashkisë Kamëz;
2. Deklaratat e kandidatit i cili deklaron se gëzon të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për Kryetar në Bashkinë Kamëz, të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019;
3. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
4. Kopje e letërnjoftimit të z. Rakip Bajram Suli sipas së cilës rezulton se z.Rakip Bajram Suli është me vendbanim në Bashkinë Kamëz;
5. Jetëshkrimin e z. Rakip Bajram Suli si kandidat për kryetar të bashkisë Kamëz;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në zbatim ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për të kandidatit për kryetar bashkie. KQZ gjithashtu ka publikuar formularin e vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e z. Rakip Bajram Suli nuk është në kushtet e nenit 2, të ligjit nr.138/2015, për refuzimin e tij si kandidat për kryetar bashkie, propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 15.05.2019, verifikoi dokumentacionin e kandidimit për kryetar z. Rakip Bajram Suli në Bashkinë Kamëz, të depozituar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, neni 165 neni 72 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor.



**Nr. 357 i Vendimit**

**Data 15.05.2019**

**Ora 11:00 e Vendimit**

Për rregjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kamëz të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", **z. Rakip Bajram Suli** për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

## PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa a, nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

## V E N D O S I:

1. Të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë Kamëz për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, **z.Rakip Bajram Suli** të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 357 i Vendimit**

**Data 15.05.2019**

**Ora 11:00 e Vendimit**

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kamëz të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", **z. Rakip Bajram Suli** për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.